



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“TVPz - TV Prizreni”
Pronar – Mufail BYTYQI
TV Prizreni
Rr/Sozi Qelebi nr. 72
Prizren

Ref: 1605/469/LIC/ni

VENDIM

për miratimin e kërkesës për ndryshim të skemës programore të TV Prizrenit,
me seli në Prizren

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Medive (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. TV Prizreni është Shërbyes Medial Adio-vizual i cili është i licencuar nga Komisioni i Pavarur i Mediave për transmetimin e programeve radiotelevizive në Regjionin e Prizrenit, me seli ne Prizren. TV Prizreni është pajisur me licencë afatëgjatë të transmetimit të KPM-së me datën 30 tetor 2009.
3. Më datën 24 shkurt 2016, TV Prizreni ka parashtruar një kërkesë, me anë të së cilës ka kërkuar miratimin e KPM-së për ndryshimin e disa segmenteve të skemës programore, me përmbajtje argëtuese-komerçiale duke i zëvendësuar me programe informative të karakterit të shërbimit publik.

Arsyetimi

4. Neni 14, paragrafi 1, i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së përcakton:

“I Licencuari duhet që në transmetimet e veta, si një nga kushtet e Licencës, t’i përmbahet formatit dhe strukturës së përgjithshme të programit në bazë të të cilit

i është dhënë Licenca dhe e drejta e përdorimit të spektrit të frekuencës. Dështimi për të vepruar në pajtueshmëri me këtë mund të rezultojë deri në anulimin e Licencës”.

5. Ndërsa Neni 14, paragrafi 2, i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së përcakton:

“I Licencuari obligohet që paraprakisht ta njoftojë me shkrim KPM-në lidhur me propozimin për ndryshime të mëdha të tipit ose burimit të programeve të dhëna në Pjesën 3 të Licencës ose të propozimit të heqjes së një përbërësi të formatit të licencuar. KPM-ja do ta njoftojë të Licencuarin me kohë, në rast se këto ndryshime të propozuara përputhen me interesat publike në bazë të të cilave i është dhënë Licenca, dhe nëse ato janë të tilla, do të ndryshojë Pjesën 3 të licencës së transmetimit në përputhje me kërkesën e të licencuarit.”

6. Ndërsa Neni 2, i Pjesës së tretë të licencës së KPM-së - Formatit i Programit, thekson:

“Nga i Licencuari kërkohet që të njoftojë paraprakisht KPM-në për ndryshime të rëndësishme të cilat ai i propozon t'i bëjë në formatin e programit siç është përcaktuar në Pjesën 3 të Licencës. KPM-ja do ta njoftojë me kohë të Licencuarin nëse këto ndryshime të propozuara janë në përputhje me interesat publike në bazë të të cilave i është dhënë Licenca e parë, dhe nëse ato janë të tilla, KPM do të ndryshojë Pjesën 3 të Licencës në përputhje me kërkesat e të licencuarit.”

7. Komisioni konstaton se ndryshimet e propozuara nga TV Prizreni, të skemës programore, duke eliminuar pjesë të programit me karakter argëtues - komercial dhe duke e plotësuar me programe të karakterit informativ të cilat janë në shërbimi të publikut të gjerë, duke transmetuar program edhe në gjuhët e komuniteteve që jetojnë në atë regjion, janë në përputhje me Politikën e Transmetimit dhe me aktet nënligjore të KPM-së.

Vendim

8. Komisioni, në takimin e mbajtur me datën 21 qershor 2016, merr vendim që ta miratojë kërkesën për ndryshimin e skemës programore të TV Prizreni, sipas ndryshimeve të propozuara në parashtrimin e kërkesës.

Lëshimi i Vendimit

9. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.



Adnan MEROVCI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



30.06.2016

datë